

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 14.02.2024

SHPLLJE VENDIMI

Drejtuar : Njësia Administrative Vreshtas

Për shtetasin/en: Sokol Zerani
Me adresë: Sheqeras, Njësia Administrative Vreshtas,
bashkia Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 3 dt. 06.01.2023 për t'u afishuar nga ana juaj njoftimi me shpallje me afat 20 ditore, pasi dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin : " larguar " dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë -----
Për Njësinë Administrative/Bashkinë

(emër, mbiemër, firmë)

Nr. 42. Prot

— Pj. A. Vreshtas
— STIMP ✓
— Dt 21.02.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr.regj.21001-01826-41-2022 (732/1510)
Datë regj.14.12.2022

Nr.vendimi 41-2023-12 (3)
Datë vendimi 06.01.2023

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues të përbërë prej:

Gjyqtarit të vetëm **Seladin PYSQYLI**, asistuar nga sekretare Vitoria Hajçe, në Gjykatë, sot më datë 06.01.2023, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen civile me palë dhe objekt:

PADITËSE: **Zana Zerani**, e bija e Ismet dhe Qazime, e datëlindjes 12.05.1970, lindur në fshatin Vidohovë, Njësia Administrative Miras, Bashkia Devoll, dhe banuese në fshatin Sheqeras, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq.

I PADITUR: **Sokol Zerani**, i biri Fadil dhe Nafije, i datëlindjes 01.04.1968, lindur e banues në fshatin Sheqeras, Njësia Administrative Vreshtas, Bashkia Maliq.

OBJEKTI: Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve.

Baza ligjore: Neni 132 e vijues i K.Familjes.

Gjykata, pasi u njoh me padinë dhe aktet bashkëlidhur, si dhe me informacionin e sekretarisë regjistruese në lidhje me çështjen që është për gjykim nga gjyqtare Eglantina Mikani,

KONSTATOI SE,

Me padinë drejtuar gjykatës, paditësja ka kërkuar zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis saj dhe të paditurit Sokol Zerani, si dhe zgjidhjen e pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës.

Pasi çështja i'u nënshtrua shortit elektronik, nga sekretaria regjistruese është konstatuar se kjo padi është ngritur edhe më parë, ku paditës është Sokol Zerani dhe e paditur Zana Zerani, me objekt zgjidhje martese, gjykimii të cilës nuk ka përfunduar. Nisur nga ky fakt, gjykata morri të dhënat nga sistemi i menaxhimit të çështjeve nga ku rezultoi se padia e parë me paditës Sokol Zerani është hedhur në short më datë 19.10.2022 dhe seanca pajtimore është zhvilluar më datë 09.12.2022 kurse seanca në vijim është planifikuar më datë 25.01.2023

Gjykata, pasi u njoh me të dhënat e të dyja çështjeve, referuar neneve 158/a pika 2/e dhe neni 299/ç të K.Pr.Civile, çmon se duhet të vendoset pushimi i gjykimit, pasi kjo dispozitë parashikon: **“Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ç) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj”**. Në rastin konkret, pushimi i gjykimit për shkak të gjykimit të të njëjtës mosmarrëveshje midis të njëjtave palë parashikohet në nenin 58 të K.Pr.Civile, i cili përcakton: *“Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar*

më parë". Sipas kësaj dispozite, që të vendoset pushimi i gjykimit, duhet që: 1-Në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme të shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë; 2-Mosmarrëveshjet të kenë njëjtin shkak dhe të njëjtin objekt.

Nga aktet rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë janë duke gjykuar dy padi për të njëjtën mosmarrëveshje dhe palët janë të njëjta, me ndryshimin që në këtë padi, paditëse është Zana Zerani dhe i paditur Sokol Zerani ndërsa në padinë tjetër paditës është Sokol Zerani dhe e paditur Zana Zerani. Në të dyja paditë objekti është zgjidhje maretse dhe shkak është i njëjtë.

Nisur nga sa më sipër, gjykata çmon se gjykimi i kësaj padie nuk mund të vazhdojë dhe çështja duhet të pushohet, pasi kjo padi është paraqitur më datë 13.12.2022, pas asaj që është duke u gjykuar nga gjyqtare Eglantina Mikani, e cila është paraqitur më datë 18.10.2022.

Përsa i takon shpenzimeve gjyqësore, paditësja ka parapaguar tarifën mbi aktet në vlerën 3.000 lek, të cilat bazuar në nenin 106 e vijues të K.Pr.Civile, duhet të lihen në ngarkim të saj.

Nisur nga fakti që midis palëve nuk ka detyrime reciproke, gjykata çmon se nuk jemi para rasteve për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit sipas parashikimit të neneve 510 e 511 të K.Pr.Civile i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 158/a pika 2/e, 58 e 299/ç të K.Pr.Civile,

VENDOSI:

-Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr.regj.21001-01826-41-2022(/1510), datë regjistrimi 14.12.2022, me paditëse Zana Zerani, i paditur Sokol Zerani, me objekt zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis palëve dhe të pasojave që vijnë nga zgjidhja e martesës në lidhje me fëmijët.

-Shpenzimet gjyqësore që përbëhen nga tarifa mbi aktet në vlerën 3.000 (tremijë) lek dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, lihen në ngarkim të paditëses.


-Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtën e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-U shpall në Korçë, sot më datë 06.01.2023.

SEKRETARE
Vitoria HAJCE



GJYQATAR
Seladin PYSOYLI



Gj

Nr.

DR
AD

Basl
06.0

në f
Sheq

banu

Marrë

Nenpi

Data e